[Printo]

[Google Translate]

LIGJ

Nr. 9786, datë 19.7.2007

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 9482, DATË 3.4.2006 "PËR LEGALIZIMIN, URBANIZIMIN DHE INTEGRIMIN E NDËRTIMEVE PA LEJE"

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9482, datë 3.4.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", bëhen këto ndryshime e shtesa:

Neni 1

Në nenin 27 fjalia e fundit ndryshohet si më poshtë:

"Për çështjet e mësipërme, subjekti kërkues, i interesuar për legalizimin e objektit pa leje, paguan tarifën e shërbimit pranë njësisë së qeverisjes vendore ku ndodhet objekti pa leje.".

Neni 2

Në nenin 32 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Shkronja "a" e pikës 1 ndryshohet si më poshtë:

"a) 20 për qind e të ardhurave në buxhetin e njësisë së qeverisjes vendore për investime vendore, në infrastrukturë e shërbime, për zonën/bllokun informal;".

b) Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

"2. Të ardhurat e arkëtuara nga pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë kalojnë për llogari të njësisë së qeverisjes vendore ku ndodhet objekti pa leje dhe destinohen prej saj për zhvillimin e infrastrukturës dhe urbanizimin e territoreve që legalizohen.".

c) Pas pikës 2 shtohen pikat 3 e 4 me këtë përmbajtje:

"3. Të ardhurat e arkëtuara nga tarifa e shërbimit dhe çdo penalitet tjetër, i cili shoqëron procesin e vetëdeklarimit dhe të legalizimit, përdoren nga organet që kryejnë shërbimin për përballimin e shpenzimeve, që do të kryhen për përditësimin e zonës me ndërtime pa leje, për përgatitjen e dokumentacionit tekniko-ligjor të nevojshëm për legalizimin e objekteve dhe financimin e studimeve urbanistike të territorit me ndërtime pa leje.

4. Mënyra, koha e mbledhjes së këtyre të ardhurave, vlera e tarifës së shërbimit dhe administrimi i saj përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.".

Neni 3

Në nenin 41 fjalia e parë ndryshohet si më poshtë:

"Njësia e urbanistikës shqyrton kërkesat e paraqitura për legalizimin e shtesave dhe u njofton subjekteve, që përmbushin kriteret e dokumentacionit, të paguajnë taksën e ndikimit në infrastrukturë dhe gjobën, kur janë objekt i saj, sipas nenit 43 të këtij ligji.".

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5441, datë 31.7.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

Copyright 2015 - www.ligjet.org